VENDIM
Nr. 271, datë 10.12.2024

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "EN.KU" SHPK PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5, 7, 9, pika dhe 5, dhe nenit 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.12.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2397/3 prot., datë 5.12.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'En.Ku' sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj",

konstatoi se:

- Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008, modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 50, datë 3.5.2013.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2397 prot., datë 13.11.2024, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin për marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 2397/1 prot., datë 25.11.2024, duke i evidentuar informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2397/2 prot., datë 27.11.2024, shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e munguar.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria "En.Ku" sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. bëhet shoqëria "Besniku" sh.p.k.

3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë "En.Ku" sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "En.Ku" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti